

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) pika 9 dhe neni 20 paragrafi (1) pika 3 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”) 4 nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14), ndërsa në përputhje me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr.02-710/5 datë 30.1.2015, në seancën e 3-të mbajtur më 30.1.2015, u përgatit Tekst i pastruar i Rregullores së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për shfrytëzimin e mjeteve për reprezentim.

Teksti i pastruar i Rregullores së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për shfrytëzimin e mjeteve për reprezentim, përfshin: Rregulloren e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për shfrytëzimin e mjeteve për reprezentim nr.01-3636/1 datë 8.7.2014 dhe Rregulloren nr.01-762/1 datë 30.1.2015, për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për shfrytëzim të mjeteve për reprezentim.

RREGULLORE
E AGJENCISË PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE PËR SHFRYTËZIM
TË MJETEVE PËR REPREZENTIM
(Tekst i pastruar)

I. Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Me këtë Rregullore redaktohet mënyra e përdorimit të mjeteve për reprezentim, autorizimet për shfrytëzim të mjeteve për reprezentim, përgjegjësitë me synimin të shfrytëzimit të mjeteve, llojin e reprezentimit dhe procedurën për shfrytëzim të reprezentimit në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Neni 2

Mjetet për reprezentim mund të shfrytëzohen për destinimin e përcaktuar me këtë Rregullore. Mjetet për reprezentim duhet të shfrytëzohen për destinimin dhe në mënyrë racionale.

II. SIGURIMI I MJETEVE

Neni 3

Mjetet për reprezentim janë siguruar me Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele,

Shpenzimet për reprezentim janë siguruar me Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në kuadër të kategorisë Shpenzime për reklama, propagandë dhe reprezentim (nënparagraf 405000 — Shpenzime për reprezentim).

Neni 4

Mjetet për reprezentim mund të shfrytëzohen si në vijim:

- Gjatë vizitave të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore në Republikën e Maqedonisë;
- Gjatë vizitave të përfaqësuesve të komuniteteve fetare, organizatave joqeveritare dhe sportive dhe shoqatave qytetare;
- Gjatë vizitave të përfaqësuesve të huaj të trupi rregullator;
- Gjatë vizitave të përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare, përfaqësues të ambasadave të huaja ose misionëve në Republikën e Maqedonisë, anëtarë të delegacioneve dhe përfaqësues të tjerë të vendeve të huaja;

- Gjatë vizitave të ekspertëve (të huaj dhe vendas) të angazhuar në bazë të projekteve, marrëveshjeve dhe të ngjajshme;

- Mbatja e mbledhjeve, seancave publike ose konferencave për shtyp të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në të cilat janë pjesëmarrës dhe përfaqësues të shoqërive tregtare radiodifuzive, operatorë të rrjeteve publike të komunikimit elektronik ose ekipe gazetare nga mediat e shtypit dhe elektronike;

- Gjatë vizitave të punës jashtë vendit për të cilat jipet vendim për udhëtim zyrtar jashtë vendit;
- Dhe raste të tjera për nevojat e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (për jubilej, përvjetore, festa e të tjera).

III. LLOJET E REPREZENTIMIT

Neni 5

Mjetet për reprezentim mund të shfrytëzohen për:

- Shërbim të pijeve joalkolike;
- Shërbim të pijeve alkolike;
- Dreka zyrtare, darka, pritje dhe të ngjajshme;
- Dhurata për raste të veçanta, si suvenire (byzhyteri), shami, kollare, ditar, mjete për në zyrë (stilolapsa), kalendarë dhe materiale të tjera reprezentimi.

Mjetet për reprezentim mund të shfrytëzohen 7 (shtatë) ditë në javë.

IV. AUTORIZIMI DHE MËNYRA E SHFRYTËZIMIT

Neni 6

Të drejtë për shfrytëzim të reprezentimit në pajtim me Rregulloren kanë:

- Kryetari i Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale,
- Zëvendës kryetari i Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, „Anëtarët e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale»
- Drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, dhe
- Zëvendës drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Neni 7

Për shfrytëzimin e mjeteve për reprezentim nga neni 5 për personat e përmendur në nenin 6 alinea 1, 2, 3 dhe 5 nga Rregullorja, pajtim jipet nga drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ose personi që drejtori e autorizon, me nënshkrim të dokumentit për shërbimin e kryer.

Neni 8

Kryetari i Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, zëvendës kryetari i Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, anëtarët e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe zëvendës drejtori i Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mund të shfrytëzojnë kartelë pagesore në emër të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizualesi si bartës i saj.

për hapjen e xhiro llogarisë dhe shfrytëzimin e kartelës pagesore është e nevojshme drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale të sjellë vendim.

Neni 9

Shfrytëzuesit e kartelave pagesore, të cekur në nenin 8 paragrafi (1) i kësaj Rregulloreje, duhet me nënshkrim personal të konfirmojnë raportin mujor që banka e dorëzon në muajin aktual, për mjetet e harxhuara nga kartelat për muajin e kaluar,

Neni 10

Mjetet finansiare në kartelën pagesore, nëse nuk harxhohen deri në fund të vitit, duhet t'i kthehen Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Pas mbarimit të mandatit të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, zëvendës kryetarit të Këshillit të Agjencisë për shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe anëtarëve të Këshillit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, përkatësisht me pushimin e funksionit të drejtorit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe zëvendës drejtorit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, janë të obliguar t'i kthejnë kartelat pagesore me të cilat janë obliguar, dhe këto kartela pagesore mbyllen.

Neni 11

Udhëheqi i Sektorit për çështje ekonomiko-finansiare i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mban evidencë nëse harxhimet e mjeteve janë në kornizat e mjeteve të parapara në Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, për atë qëllim, nëse paraqiten shpenzime më të mëdha nga sa janë paraparë, njoftohen me shkrim nga Udhëheqësi i Sektorit për çështje juridike dhe çështje ekonomiko-finansiare, ndihmës udhëheqësi i sektorit për çështje juridike dhe çështje ekonomiko-finansiare të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Neni 12

Në raste të shfrytëzimit për reprezentim jashtë normave të dispozitave dhe Rregullores, personi që ka bërë porosinë është i obliguar të kompensojë shpenzimet nga llogaria personale(private).

V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 13

Nëse nuk është e paraparë në Rregullore, atëherë janë të vlefshme dispozitat nga ligjet pozitive në Republikën e Maqedonisë.

Neni 14

Kjo Rregullore hyn në fuqi me ditën e miratimit të saj, dhe do të shpallet në tabelën e shpalljeve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe audiovizuele.

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje ndalet vlefshmëria e Rregullores për shfrytëzim të mjeteve për reprezentim në Këshillin për radiodifuzion të RM-së nr,012042/1 datë 26.4.2012.

Neni 15

(Neni 11 nga Rregullorja e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për shfrytëzim të mjeteve për reprezentim nr.01-3636/1 datë 8.7.2014 година)

Sektori për çështje ekonomiko-finansiare e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, udhëheq evidencë nëse shpenzimet e mjeteve janë brenda kornizave të mjeteve të siguruar me Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, për atë qëllim, nëse paraqiten shpenzime më të mëdha nga sa janë paraparë, njoftohet me shkrim Udhëheqësi i Shërbimit profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele si dhe Drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Zëvendës drejtori i Agjencisë.

Neni 16

Me Rregulloren nr.01-762/1 datë 30.1.2015, për ndryshim dhe plotësim të Rregullores të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për shfrytëzimin e mjeteve për reprezentim, neni 14 nga Rregullorja e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për shfrytëzimin e mjeteve për reprezentim nr.01-3636/1 datë 8.7.2014, fshihet.

(Neni 14 nga Rregullorja e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për shfrytëzim të mjeteve për reprezentim nr.01-3636/1 datë 8.7.2014)

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje kryhet në formë të shkruar.

Nr.01-843/1
03.02.2015
Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetar i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.